



**Funded by
the European Union**



Përmbledhje e Ligjit për Barazi Gjinore

Ligji Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive si një vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë. Ky ligj siguron trajtim dhe mundësi të barabarta për të gjithë, pavarësisht gjinisë apo identitetit gjinor, si në jetën publike ashtu edhe në atë private.

Seksi – Mashkull/Femër	Gjinia – Burrë/ Grua
Karakteristikat biologjike dhe fiziologjike të cilat dallojnë meshkujt dhe femrat.	Rolet që i jep shoqëria individëve në bazë të seksit në të cilin lindin. Shembull, nga gratë pritet që të kujdesen për familjen dhe shtëpinë ndërsa nga burrat pritet që të punojnë dhe sigurojnë familjen financiarisht.

Të drejtat e mbrojtura nga ky ligj përfshijnë:

E drejta për barazi dhe mosdiskriminim gjinor

- Ligji garanton ushtrimin e plotë dhe të barabartë të të drejtave të njeriut për gratë dhe burrat. Kjo përfshin mungesën e diskriminimit në bazë gjinore në mundësitë, ndarjen e burimeve, përfitimet dhe qasjen në shërbime.
- Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë gjinor, duke përfshirë trajtimin më pak të favorshëm të grave për shkak të shtatzënisë dhe amësisë, gjendjes martesore, kombësisë, racës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, statusit social, besimit fetar, moshës, ose ndonjë baze tjetër të mbrojtur me ligj.
- Ndalohet dhuna në baza gjinore, ngacmimi dhe ngacmimi seksual.
- Sigurohet mbrojtje për personat që paraqesin ankesa për diskriminim, ngacmim apo ngacmim seksual.

Diskriminimi i drejtpërdrejtë gjinor

është kur një person trajtohet më keq vetëm pse i përket një gjinie, krahasuar me një person të gjinisë tjetër në të njëjtën situatë.

Diskriminimi i tërthortë gjinor

ndodh kur një rregull ose praktikë që duket neutrale vendos një person të një gjinie në pozitë më të pafavorshme në krahasim me një person të gjinisë tjetër. Përfshirë bëhet vetëm kur ajo masë ka një qëllim legjitim dhe përdoret në mënyrë të arsyeshme e të domosdoshme.

E drejta për mundësi dhe trajtim të barabartë në jetë publike

- Garantohet trajtim i barabartë me synim përfaqësimin prej së paku 50% për secilën gjini në të gjitha organet legjislative, ekzekutive, gjyqësore dhe institucionet e tjera publike, përfshirë organet drejtuese dhe vendimmarrëse.
- Partive politike u kërkohet të zbatojnë masa për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të burrave dhe grave në strukturat e tyre.

E drejta për mundësi dhe trajtim të barabartë në punë

- Ndalohet diskriminimi në kushtet për punësim, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe kushtet e rekrutimit.
- Kërkohet sigurimi i qasjes së barabartë në trajnim, zhvillim profesional, avancim dhe kushte pune, përfshirë pagën e barabartë për punë të barabartë.
- Mbrohet e drejta për anëtarësim dhe përfshirje të barabartë në organizatat e punëtorëve ose punëdhënësve.
- Sigurohet e drejta për një mjedis pune pa trajtim të padëshirueshëm të natyrës seksuale, duke përfshirë sjelljet fizike, verbale ose joverbale që krijojnë një mjedis frikësimi, armiqësor ose poshtërues.
- Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë në bazë të gjinisë në të gjitha skemat e sigurimit shoqëror në punë.
- Sigurohet e drejta për të balancuar detyrimet profesionale dhe familjare, duke përfshirë organizimin e punës dhe orarit në mënyrë që të garantohet kthimi në të njëjtin vend pune pas pushimit të lindjes, pushimit prindëror, pushimit të abortit, pushimit mjekësor ose kohës së kaluar jashtë vendit të punës për shkaqe urgjente familjare, apo aftësi profesionale.

E drejta për mundësi dhe trajtim të barabartë në arsim

- Ndalohet diskriminimi mbi bazë gjinore në institucione arsimore në të gjitha nivelet, duke përfshirë qasjen në arsimim, procesin e pranimit, qasjen në shërbime, mjete dhe përfitime si bursat, rezultatet e vlerësimit, marrjen e diplomave dhe titujve shkencor, si dhe qasjen në trajnime profesionale.
- Kërkohet që mjetet mësimore dhe kurrikulat shkollore të bazohen në barazinë gjinore dhe të eliminojnë stereotipet negative dhe paragjykimet.

Njohja dhe vlerësimi i punës së papaguar

- Puna e papaguar e grave dhe burrave (si kujdesi për familjen, fëmijët, anëtarët e tjerë të familjes, dhe puna në bujqësi dhe ekonomi familjare) vlerësohet si kontribut për zhvillimin e familjes dhe shoqërisë.

Ky ligj përcakton **masat e përgjithshme dhe të veçanta** për mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave të barabarta të grave dhe burrave.

Masat e përgjithshme janë masa normative që parandalojnë diskriminimin gjinor dhe garantojnë barazi mes grave e burrave.	Masat e veçanta janë masa të përkohshme që synojnë të garantojnë dhe të nxisin barazinë gjinore në fusha ku ka pabarazi. Ato merren për të përshpejtuar arritjen e barazisë reale mes grave dhe burrave dhe nuk konsiderohen diskriminim. Këto masa ndalojnë sapo të arrihen qëllimet për barazi.
Shembuj: 1. Analiza gjinore në institucione, organizata apo fusha të ndryshme 2. Strategji dhe plane të veprimit për barazi gjinore, në përputhje me Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 3. Përfshirjen e integritimit gjinor në të gjitha politikat, dokumentet dhe legjislacionin 4. Përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve	Shembuj: 1. Kuota gjinore për të arritur përfaqësimin e barabartë të grave dhe burrave 2. Programe për të mbështetur rritjen e pjesëmarrjes së gjinisë më pak të përfaqësuar në vendimmarrje dhe jetën publike 3. Masa afirmative për rekrutim, punësim dhe ngritje në detyrë në fusha ku ka pabarazi, kur kandidati/ja i/e gjinisë së nën-përfaqësuar ka kualifikimet njejta dhe të duhura sipas vlerësimit objektiv